LIGJ
Nr. 87/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2009, PËR PROJEKTIN "ENERGJIA UJORE DHE SIGURIA E DIGAVE NË KASKADËN E DRINIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2009, për projektin "Energjia ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit", sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9199, datë 30.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2009 PËR PROJEKTIN "ENERGJIA UJORE DHE SIGURIA E DIGAVE NË KASKADËN E DRINIT"

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (notë verbale nr. 125/09, e datës 25 shtator 2009),

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Shqipërisë të marrë për projektin "Energjia ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit" numri i projektit: 2009.6653.1, nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) një hua me kushte të favorshme, e cila

akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vleftë prej deri në 20.000.000 eurosh (me fjalë: njëzet milionë euro), kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafin 2 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2017.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezulton nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, _____, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.